




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Kadrush Murtezi B.I.

Emri Tregtar: N.SH. ILIRI

NUI: 811101930

Pronari: Kadrush Murtezi

OSHMA: Radio dhe TV ILIRIA

Adresa: Rr/Hoxhë Jonuzi, p. n., Viti

Emri i Biznesit: "Connection Media" SH.P.K.


NUI: 810530528

Pronari: Muhamed Krasniqi

Adresa: Rr/ Meto Bajraktari, p.n. Prishtinë

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës të Radio Iliria dhe TV Iliria, me seli në
Komunën e Vitisë



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Iliria është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin tokësorë të programeve të radios, me seli në komunën e Vitisë. KPM, me vendimin e datës 20 tetor 2016, ka bërë ripërtëritjen e licencës së Radio Iliria edhe për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. TV Iliria është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizual me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin tokësorë të programeve televizive, me seli në komunën e Vitisë. KPM, me vendim e datës 3 tetor 2019 ka bërë zgjatjen e përkohshme të afatit të licencës së TV Iliria.
4. Më datën 20 tetor 2021, Radio dhe TV Iliria ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio dhe TV Iliria nga biznesi Kadrush Murtezi B.I., emri tregtar N.SH. ILIRI, me Numër Unik Identifikues (NUI) 811101930 dhe me pronar z. Kadrush Murtezi tek Biznesi Connection Media SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 811589730, me pronar z. Muhamed Krasniqi.

Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë, pronari aktual i Radio dhe TV Iliria ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim është mosha e shtyrë, gjendja shëndetësore dhe pamundësia për zhvillimin e radio dhe televizionit.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio dhe TV Iliria, përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka planifikuar zhvillimin e Radio dhe TV Iliria përmes rritjes së cilësisë së programeve, transmetim të programeve për të gjitha grupet e moshave të shoqërisë si dhe rritjen e tregut të reklamës, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare mbi shkallën dhe burimin e financimit.
11. Komisioni konstaton se, paraprakisht Radio dhe TV Iliria ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së.
12. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, zotimet për rritjen e cilësisë dhe llojeve të programeve, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio dhe TV Iliria është në interes të publikut.
13. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

14. Komisioni në takimin e tij të datës 9 nëntor 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio dhe TV Iliria nga biznesi Kadrush Murtezi B.I., emri tregtar N.SH. ILIRI me Numër Unik Identifikues (NUI) 811101930, dhe me pronar z. Kadrush Murtezi tek Biznesi Connection Media SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI) 811589730, me pronar z. Muhamed Krasniqi.

15. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të Radio dhe TV Iliria nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.

16. Me anë të këtij vendimi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Radio dhe TV Iliria barten te pronari i ri.

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22.11.2021

datë